



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë e Huaj C (5)

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 0 leksione / 40 seminare

Viti / Semestri : Viti III , Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhën frënge ‘‘Gjuhë dhe Komunikim’’

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Plani mesimor i këtij kursi realizohet në 40 seanca seminare, në të cilat parashikohet të zhvillohen kapitujt 4, 5, 6 secila e përbërë nga tre mësimet dhe ku secila ndahet nga dy njësi didaktike. Në këto seanca seminari, parashikohen të kryhen aktivitete të aspektit gjuhësor dhe pragmatik. Studenti aftësohet në të kuptuarin me gojë (dëgjimin) dhe shprehurit me gojë sikurse në të kuptuarin me shkrim (studimi i dokumenteve të shkruar si tekste të ndryshme dhe dokumente autentike) dhe të shprehurit me shkrim ku studenti paraqet tekste të shkruar si ese të shkurtra, letra korrespondence, etj.

Objektivat specifike lëndore:

Studenti duhet :

- 1.Të marrë njohuri lidhur me leksikun në fusha dhe aspekte nga jeta e përditshme si përshembull për mediat, për aktivitete që kryhen gjatë kohës së lirë, udhëtimet
- 2.Të mund të shprehë sygjerime, të japë opinione
- 3.Të mund të bëjë prezantime turistike të shkurtra, të bëjë rezervime, etj.
- 4.Të mund të shprehë objektivat, të justifikojë përzgjedhjet